



BASHKIA
TIRANË



Drejtuar: Operatorit Ekonomik "COLOMBO" shpk

Adresa: Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **"Rikonstrukcion i Bibliotekës së Qytetit nr.3"**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstrukcion i Bibliotekës së Qytetit nr.3"**, duke realizuar rikonstrukcionin Bibliotekës së Qytetit nr.3, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Nr.REF.procedurës: REF - 50246 – 02- 22-2018

Fondi limit: 6.625.869 (gjashte milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.132 datë "Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018" konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot. 5595/5 datë 08.01.2018

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 23.03.2018 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr.8 datë 26.02.2018**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "CARA" shpk me nr. NUIS K02772920F

Vlera e ofertës pa TVSH =**4.253.951** (katër milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) **leke pa tvsh.**

2. Operatori Ekonomik "Shendelli" shpk me nr. NUIS K07924803N

Vlera e ofertës pa tvsh = **4.477.794** (katërmilion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) **leke**

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Drini-A & Selami” shpk, me nr.NUISJ67902505V & J77304706L

Vlera e ofertës pa tvsh = **4.274.299** (katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) leke.

4. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion ” shpk me nr. NUIS K71401004W

Vlera e ofertës pa tvsh = **5.131.697,2** (pesë milion e njëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje dy) leke.

5. Operatori ekonomik “INA ” shpk me nr. NUIS J61814009W

Vlera e ofertës pa tvsh = **4.905.219** (katër milion e nëntëqind e pesë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) leke.

6. Operatori ekonomik “Alesjo” shpk me nr. NUIS L37311801K

Vlera e ofertës pa tvsh = **5.188.169** (pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) leke.

7. Operatori ekonomik “Rafin Company” shpk me nr. NUIS L52125110A

Vlera e ofertës pa TVSH = **4.154.738** (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lek.

8. Operatori Ekonomik “Shpresa-AI” shpk me nr. NUIS.K31321021N

Vlera e ofertës pa TVSH = **5.289.603** (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tre) lekë pa TVSH

9. Operatori Ekonomik “COLOMBO ” shpk me nr. NUIS J82916489E

Vlera e ofertës pa TVSH = **3.614.079** (tre milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e nëntë) leke.

10. Operatori ekonomik “SENKA” shpk me nr. NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës pa TVSH = **5.307.290** (pesë milion e treqind e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë.

11. Operatori Ekonomik “S.A.G” shpk me nr. NUIS K51802003G

Vlera e ofertës pa TVSH = **6.168.351** (gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik “CARA” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori ekonomik “CARA” shpk, nuk plotëson pikën 2 të Kriteret e Vecanta te Kualifikimit/Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar.

*Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2016,2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **6.625.869** (gjashte milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të APP-së konstatoi se shoqëria "Cara" shpk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri vetëm xhiron e vitit 2016 pra nuk ka paraqitur xhiron e vitit 2017. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërisë lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pasaktë.

Së dyti Autoriteti Kontraktor në dokumentat standart të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 6 ka kerkuar

6. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa (per tre muajt e fundit) te pakten 7 (shtatë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme, ku nga keta te jene te pakten: 2 (dy) punonjës me kategori të I, 3 (tre) punonjes punonjës me kategori te III, 2(dy) punonjës me kategori te III

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitte perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme)

Shoqëria "Cara" shpk, ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri si punonjës me kategori të II-të vetëm Z. K.A nga tre punonjës të kërkuar. AK ka kërkuar në dokumentat Standarte të Tenderit 3(tre) punonjës me kategori të II-të.

Shoqëria e mësipërme në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm një punonjës me kategori të II-të

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomikë "Cara" shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik në pikën 6 , për rrjedhojë i pavlefshëm

Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12, ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës deri në dy ton dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm një kamionçinë dhe ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm një kamion. Kamionat e tjerë të mësipërme të deklaruara nga operatori ekonomikë si dhe kamioncinat e tjera **kanë kapacitetin mbajtës mbi 5 ton për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori Ekonomik “Shendelli” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori ekonomik “**Shendelli**” shpk, nuk plotëson pikën 2 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar.

*Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2016,2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **6.625.869** (gjashte milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të app-së konstatoi se shoqëria “Shendelli” shpk nuk ka paraqitur në përmbushje xhiron e vitit 2017. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërisë lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pasaktë.

AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në Kriteret e Vecanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Vërtetimi i Debitit të paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik “Shendelli” shpk, nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit, konkretisht muajin Janar 2018.

*Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 23.02.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 23.03.2018 brenda këtij afati operatori ekonomik e kishte detyrim të kishte bërë pagesën e faturës së muajit Janar 2018 si dhe të pajisej me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se **”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhje të pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Drini-A & Selami ” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Bashkimi i Operatorëve ekonomik **”Drini-A” dhe ”Selami” shpk**, nuk plotësojnë pikën 2 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar.

Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2016,2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **6.625.869** (gjashte milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të app-së konstatoi se shoqëritë ”Drini-A dhe Selami” shpk kanë paraqitur në përmbushje të këtij kriteri vetëm xhiron e vitit 2016 pra nuk kanë paraqitur xhiron e vitit 2017(asnjëra nga shoqëritë!). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërive lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhje të pasaktë.

Së dyti Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 6 citohet

6.Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në list pagesa (per tre muajt e fundit) të pakten 7 (shtatë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, ku nga keta të jene të pakten: 2 (dy) punonjës me kategori të I, 3 (tre) punonjës me kategori të III, 2(dy) punonjës me kategori të III

(Per punonjesit e siperpermendur të paraqiten deshmitë perkatese të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (të vlefshme)

Shoqëritë e mësipërme në përmbushje të këtij kriteri kanë paraqitur vetëm dy punonjës me kategori të II-të dhe një punonjës me kategori të I-rë.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë , është i paplotë, **për rrjedhje të pavlefshëm.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Operatori Ekonomik “Kevin Konstruksion ” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës deri në dy ton dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm një kamionçinë. Kamionat e tjerë të mësipërme të deklaruara nga operatori ekonomikë si dhe kamioncinat e tjera **kanë kapacitetin mbajtës jo sipas DST, për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Operatori Ekonomik “INA” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12,

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës deri në dy ton dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës vetëm një kamionçinë. Kamionat e tjerë të mësipërme të deklaruara nga operatori ekonomikë si dhe kamioncinat e tjera **kanë kapacitetin mbajtës jo sipas DST, për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Operatori ekonomik “Alesjo” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 6 citohet

6. Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në list pagesa (për tre muajt e fundit) të pakten 7 (shtatë) punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, ku nga këta të jete të pakten: 2 (dy) punonjës me kategori të I, 3 (tre) punonjës me kategori të III, 2 (dy) punonjës me kategori të III

(Për punonjesit e sipërpermendur të paraqiten deshmite perkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punës (të vlefshme)

Shoqëria “Alesjo” shpk, ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur dy punonjës me kategori të II-të, nga tre punonjës të kërkuar, si dhe nuk ka paraqitur asnjë punonjës me kategori të tretë.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12,

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar të vihet në dispozicion midis të tjerave dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës asnjë kamion.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

7. Operatori ekonomik “Rafin Company” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 6 citohet

6.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa (per tre muajt e fundit) te pakten 7 (shtatë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme, ku nga keta te jene te pakten: 2 (dy) punonjës me kategori të I, 3 (tre) punonjes punonjës me kategori te III, 2(dy) punonjës me kategori te III

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme)

Shoqëria “Rafin Company” shpk, ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri si punonjës me dëshmi kualifikimi të punonjës por nuk ka vërtetuar çfarë kategorie I përkasin.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomikë “ Rafin Company” shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik në pikën 6 , për rrjedhojë I pavlefshëm.

Së dyti, Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 12,

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion midis të tjerave dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapaciteti mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton dhe dy kamioncina** për ekzekutimin e kontratës.

Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur një kamioncinë dhe një kamion duke mos përmbushur kriterin e mësipërm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

8. Operatori Ekonomik “Shpresa-Al” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion midis të tjerave dhe dy kamiona vetëshkarkues me **kapacitet mbajtës për secilën kamion minimum 3.5 Ton dhe maksimumi 5 ton** për ekzekutimin e kontratës. Nga sa më sipër rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt vetëm një kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Shpresa-AI” shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik në pika 12, për rrjedhojë I pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë kualifikuar si ofertë të suksesshme:

- **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik ”COLOMBO” shpk kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **3.614.079** (tre milion e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **4.843.295** (katër milion e tetëqind e dyzetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

- **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Senka ” shpk kualifikohet në vend të dytë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **5.307.290** (pesë milion e treqind e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **6.368.748** (gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e tetë) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

- **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “S.A.G” shpk kualifikohet në vend të tretë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **6.168.351** (gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e një) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **7.402.021** (shtatë milion e katërqind e dy mijë e njëzetë e një) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.04.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenet 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik “**S.A.G.**” **shpk**, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 13404 Prot. datë 05.04.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **”Rikonstruksion i Bibliotekës së Qytetit nr.3”**

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 6867/6 Prot. dt. 05.04.2018, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 6867/7 Prot. datë 05.04.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e Operatorit Ekonomik, “**S.A.G.**” **shpk** , ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik i mësipërm dhe është konsideruar i drejte dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatori Ekonomik “**S.A.G.**” **shpk**, me ane të shkresës Nr. 13404/2 datë 06.04.2018 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 17.04.2018, me anë të shkresës nr. 6867/8, është hequr pezullimi i Urdhërit pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP-së.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatori Ekonomik ”COLOMBO” shpk, me adresë:** Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **3.614.079** (tre milion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.